



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 04.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesave për ri-shqyrtim** të datës 27.03.2025 të parashtruara nga Operatoret Ekonomik **DataProgNet SHPK** dhe **Cactus Sh.a.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN”** me nr. prokurimi 206-25-90-2-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohen**, si te pa bazuara kërkesat për rishqyrtim e OE **DataProgNet SHPK** dhe **Cactus Sh.a.** te datës 27.03.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN”** me nr. prokurimi 206-25-90-2-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, të datës 24.03.2025 te publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK, i datës 24.03.2025;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatoret Ekonomik DataProgNet SHPK dhe Cactus Sh.a. me datën 27.03.2025 kane parashtruar kërkesa për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN”** me nr. prokurimi 206-25-90-2-1-1. Autoriteti Kontraktues me datë 04.04.2025 ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas oe DataProgNet SHPK

- Nenin 1 Qëllimi të LPP;
- Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti të LPP;
- Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së;
- Nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të LPP-së dhe nenin 40 Ekzaminimi,

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas oe Cactus Sh.a.

- Neni 1 – Qëllimi
- Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Shkeljet e dispozitave të RRUOPP
- Neni 38- Sqarimi i Tenderëve

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet sipas oe DataProgNet SHPK

Me datë 24.03.2025, nga Autoriteti Kontraktues (AK), përmes sistemit elektronik eProkurimi, jemi njoftuar me Letërat standarde për tenderuesin e eliminuar për Lot-2 dhe për tenderuesin e suksesshëm për Lot-1 për projektin me titull: "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN" dhe nr. prokurimi: 206-25-90-2-1-1. DataProgNet SH.P.K, në lidhje me projektin të ndarë në dy Lote, është shpallur i suksesshëm në Lot 1, kurse i eliminuar në Lot 2.

- Përmes kësaj kërkesë, ju drejtohem për të kërkuar rishqyrtimin e vendimit të datës 24.03.2025, lidhur me refuzimin e ofertës sonë për Lot-2, me arsyetimin se kemi ofertuar me të njëjtit Menaxher të projekti në të dy Lot-et (Lot-1 dhe Lot-2).
- Në dosjene tenderit nuk është cekur se nuk kemi të drejtë të ofertojmë me të njëjtin staf për dy Lot-et dhe për këtë arsye kemi ofertuar me të njëtin menaxher në dy Lot-et edhe pse kemi njaft staf në kompani që merren me Menaxhimin e projekteve.
- Ne konsiderojmë se refuzimi i ofertës sonë për Lot-2 nuk reflekton në mënyrë të drejtë, pasi që kapacitetet tona për menaxhimin e projektit janë të përmbushura, duke marrë parasysh se projektet në fjalë për dy Lot-et gjatë viteve 2023–2024 janë zhvilluar dhe implementuar nga kompania DataProgNet SH.P.K.
- Nga përvojat tona dhe legjislacionet në fuqi në institucione publike të Republikës së Kosovës, në Kompanitë private dhe në përvojat globale që kemi, një person brenda një institucioni publik apo privat mund të Menaxhoj më shumë se një projekt paralelisht, këtë dukuri e kemi vërejtur në disa institucione Publike të Republikës së Kosovës, e praktikojmë edhe ne në kompani, por kemi pasur rastin që edhe në projekte tona që kemi realizuar me sukses në Ministrinë e shëndetësisë, një person nga Ministria e shëndetësisë ka menaxhuar paralelisht më shumë se një projekt, çka e vlersojmë se ka pasur të drejtë ligjore.
- Ne kemi konsultuar me shumë kujdesë Ligjin e KRPP-së dhe nuk kemi gjetuar as në Ligjin e KRPP-së që e ndalon një person të menaxhoj më shumë se një projekt paralelishtë.
- Duke pasur parasysh që të dy Lote-et janë pjesë e të njëjës dosje të prokurimit nga i njëti institucion, një menaxhim i unifikuar do të mundësonte një implementim më efikas dhe të koordinuar.

Duke marrë parasysh këto fakte, ju lutem të rishqyrtoni vendimin e datës 24.03.2025 dhe të merrni parasysh miratimin e menaxherit të projektit për të dy Lot-et, me qëllim të përmbushjes së suksesshme të objektivave të projektit.

Mbetem në shpresë se kërkesa e parashtruar për rishqyrtim nga kompania jonë të shqyrtohet nga AK Ministria e shëndetësisë dhe të aprovet si e bazuar, referuar në faktet e prezentuara më lartë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmi material i përgatitjes së ofertës si dhe dëmet tjera do të pasqyrohen pas një analize të detajuar profesionale.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet sipas oe Cactus Sh.a.

Duke u bazuar ne dispozitat e LPP-së, konkretisht nenit 108 A, parashtrorjmë kërkesë për rishqyrtim. Ne rastin konkret kërkesa parashtrorhet ndaj njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues te datës 24.03.2025.

Fillimisht, lejoni që të shprehim pakënaqësinë tonë të thellë lidhur me vlerësimin dhe vendimin e marrë nga autoriteti kontraktues. Eliminimi ynë nga ky tender nuk është vetëm një veprim jo profesional, por gjithashtu i konsiderojmë si një vendim tendencioz dhe të pasigurt që ka dëmtuar ndjeshëm mundësinë për një proces fer dhe te drejtë te prokurimit.

Ne jemi thellësisht të shqetësuar nga fakti që autoriteti kontraktues ka nxjerrë një vendim në të cilin theksohet se kemi dështuar të plotësojmë kushtet e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, pa ofruar asnjë bazë ligjore të qartë apo arsyetim të detajuar mbi kriteret që supozohet se nuk i kemi plotësuar. Në këtë kontekst, kërkojmë që autoriteti kontraktues të rishikojë këtë vendim dhe të ofrojë një arsyetim më të detajuar dhe të bazuar në ligjin për prokurimin publik dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë proces. Në rastin konkret, nuk është paraqitur asnjë provë apo fakt që të mbështesë pretendimet ne eliminimin tonë nga kjo procedurë e prokurimit, dhe kjo përbën një shkelje të parimeve të transparencës, drejtësisë dhe barazisë që janë thelbësore për një proces të rregullt dhe të drejtë të prokurimit.

Më poshtë, ne do të paraqesim kundërshtimet tona të detajuara, të cilat janë të bazuara në ligjin e prokurimit dhe aktet nënligjore përkatëse. Ne do të paraqesim gjithashtu fakte dhe argumente që vërtetojnë se vendimi i autoritetit kontraktues është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me legjislacionin në fuqi dhe në një mënyrë që është tendencioze dhe i paarsyeshme ndaj kompanisë sonë.

Pika e parë e eliminimit nga ana e AK,

Kapaciteti teknik dhe profesional;

- Nuk i keni plotësuar te gjitha kriteret siç janë kërkuar ne NJK dhe DT. Oferta juaj është e papërgjegjshme për lotin 2, pasi qe Tek Kapaciteti teknik dhe profesional Për Lot-in 2 eshte kërkuar: Operatori ekonomik duhet te ketë staf për kryerjen e shërbimeve si ne vijim a. 1(një) Menaxher te projektit - Inxhinier i diplomuar i Kompjuterikes ose telekomunikacion ose Master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike, me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme (të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), i certifikuar me certifikate valide në PMP ose ekuivalente.

Ju keni ofruar si menaxher te projektit z. Sabedin Meha, te njëjtin person si për lotin 1 ashtu dhe lotin 2, ndërsa ne DT kriteret kanë qene te ndara për secilin lot veç e veç, qe do te thotë janë kërkuar dy menaxherë te projektit, andaj ju me ofertën e juaj e mbulonit vetëm njërin Lot, ne këtë rast për shkak te vlerës me te madhe u eshte përzgjedhur Lot 1 për kontrate.

Sqarim në lidhje me plotësimin e kësaj pike nga ana e OE:

Na lejoni të sqarojmë se kemi plotësuar në tërësi kriteret që Autoriteti Kontraktues (AK) ka konsideruar si të pa plotësuar. Konkretisht, kemi ofruar analisten e projektit, znj. Valentina Haziri, e cila përmbush plotësisht kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Ashtu siç kërkohet në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, për Lot-in 1, pika b.1 (një), "Analist i projektit - Inxhinier i diplomuar i Kompjuterikës dhe Telekomunikacionit ose Master i Shkencave ose Inxhinierisë Kompjuterike, me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit në cilësinë e analistit të sistemeve softuerike (të zhvilluara në platformën Microsoft .NET me SQL Server)," ne kemi ofruar një kandidaturë që plotëson të gjitha kërkesat për këtë pozitë.

Znj. Haziri është e diplomuar në fushën e kërkuar dhe po ashtu ka një diplomë Master, e cila është e përshtatshme për pozitat e kërkuara në këtë projekt. Kemi ofruar dëshmi të plota, duke përfshirë diplomën e saj Bachelor dhe Master, si dhe certifikime të shumta (cilat janë) në fushën e Analizës dhe Menaxhimit të Projekteve si dhe eksperiencë shumë vjeçare (më shumë se sa që është kërkuar (5 vite)), jo vetëm ekspertizë lokale, por edhe në sferën ndërkombëtare (Projekte nga US, Zvicër, etj) të cilat plotësojnë kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Nëse shqyrtojmë kërkesën e dosjes së tenderit, ajo specifikon mundësinë për të ofruar një Master në shkencat ose inxhinierinë kompjuterike. Kandidati ynë është një Master në Shkenca, me titull të studimeve të thelluara në fushën e Teknologjisë së Informacionit, që përputhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkesat e pozicionit.

Dallimet që mund të kenë titujt akademikë mes institucioneve janë të natyrshme, por përmbajtja dhe fusha e studimeve është pothuajse e njëjtë, me disa dallime të papërfillshme që nuk ndikojnë në përmbushjen e kërkesave të tenderit.

- Të dy titujt përfaqësojnë fusha të inxhinierisë teknologjike,
- Të dy titujt përfshijnë elemente të teknologjisë së informacionit dhe përdorimin e saj për zhvillimin dhe menaxhimin e sistemeve dhe infrastrukturave,
- Të dy titujt përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e sistemeve teknologjike dhe rrjetave që përfshijnë informacionin dhe telekomunikacionin,
- Të dy titujt lidhen me studimin dhe aplikimin e sistemeve teknologjike, qoftë në nivelin e infrastrukturës, softuerëve ose sistemeve të komunikimit.

Në këtë rast, ne konsiderojmë se autoriteti kontraktues ka pasur mundësinë të kërkojë informacione shtesë ose plotësuese për të sqaruar çdo pasiguri në lidhje me përputhshmërinë e titujve akademikë, në mënyrë që të shmanget interpretimi i gabuar i dokumentacionit.

Duke pasur parasysh parimet themelore të Ligjit të Prokurimit Publik, të cilat përfshijnë QËLLIMIN e realizimit të kontratës në mënyrë efektive dhe të drejtë, ne besojmë se ndonjë devijim i vogël në këtë rast nuk do të ndikonte në realizimin e qëllimit të kontratës, *mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike* për autoritetin kontraktues. Kjo do të mundësonte një përfundim të suksesshëm të procesit të tenderimit pa ndikim në cilësinë e realizimit të kontratës.

Po ashtu, gjatë vlerësimit nga ana e AK, nuk është përfillur fare Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, konkretisht pika 2 dhe pika 4, ku thuhet se:

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pika e dytë e eliminimit nga ana e AK,

Ju keni ofruar te njëjtin staf për te dy llotet edhe pse ne DT kanë qen te ndara kriteret e kërkuara për stafin e angazhuar ne këtë projekt, dhe si te tillë nuk e plotëson kriterin e kërkuar ne FDT.

Në rastin konkret, na lejoni të sqarojmë se kjo paraqet një vlerësim të padrejtë dhe në kundërshtim me kriteret e vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Ne si OE kemi ofruar stafin ashtu siç është kërkuar për të dyja lotet. Askund në dosjen e tenderit nuk është specifikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, taksative, se nuk mund të ofrohet stafi i njëjtë për të dyja lotet.

Ky vlerësim nga ana e autoritetit kontraktues është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), konkretisht me nenin 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Eliminimi në këtë pikë është i papranueshëm dhe i paarsyeshëm. Në këtë rast, autoriteti kontraktues nuk ka përfillur kriteret e vlerësimit që vetë ka përcaktuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, duke bërë kështu një vlerësim të paqartë dhe tendencioz.

Dispozitat e shkelura nga ana e autoritetit kontraktues

Neni 1 - Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale,

të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke tu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1 i cili thotë se:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2,4 i cili thotë se:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, pika 2 dhe 4 e këtij neni

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm, qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen, konkretisht pika 2 dhe 4 i cili thotë se:

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Bazuar ne sqarimet me lartë, faktet dhe provat e paraqitura, kërkojmë nga Autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë, qe te nxjerrë:

VENDIM

- **Analimin e Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 24.03.2025, për shkak të shkeljes së procedurave të rregulluara nga Ligji i Prokurimit Publik, dhe lenden ta kthej ne rivlerësim.**
- **Te shpërblehemi ne si operator me çmim me te lirë me kontratë,**
- **Sigurimin që procesi i prokurimit të jetë i ligjshëm dhe të respektojë parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme.**

Dëmet materiale: Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim ku përfshihen kostot për hartimin e kërkesës për rishqyrtim, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e kërkesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.

Përgjigja e AK ne lidhje me pretendimet ankimore te oe DataProgNet SHPK

Konsiderojme se pretendimet e juaja ankimore jane te pa bazuara si te tilla Refuzohen dhe mbetet ne fuqi vendimi i AK.

Fillimisht ju eshte dashta ta lexoni me me vemendje Dosjen e Tenderit dhe kerkesat e parashtruara nga AK ne DT, meqense kriteret jane te qarta dhe jane ndare saktesisht çka kerkoet per Lot 1 dhe çka per Lot 2, andaj i tere stafi i ofruar duhet te jete ndaras per Lot 1 nga Lot 2, e jo nje person ti mbuloj dy lote.

Ju eshte dasht qe keto dilema ti trajtoni ne kohen e sqarimeve shtese ne DT, por kete nuk e keni bere, andaj ne fazen e vleresimit, ju me te drejte jeni shperblyer vetem me nje Lot qe e keni me vlere me te madhe, meqense oferta tjetere eshte trajtuar si e papergjegjshme, ne te kunderten sikur oferta tjetere te ishte e pergegjshme ju do te shperbleheshit vetem me Lot 2.

E rikonfirmojme konstatimin e komisionit vleresues se oferta juaj është e papërgjegjshme për lotin 2, pasi qe Tek Kapaciteti teknik dhe profesional Për Lot-in 2 eshte kërkuar: **Operatori ekonomik duhet te ketë staf për kryerjen e shërbimeve si ne vijim a. 1(një) Menaxher te projektit - Inxhinier i diplomuar i Kompjuterikes ose telekomunikacion ose Master i shkencave ose Inxhinierisë kompjuterike, me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme (të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), I certifikuar me certifikate valide në PMP ose ekuivalente.**

Ju keni ofruar si menaxher te projektit z. Sabedin Meha, te njëjtin person si për lotin 1 ashtu dhe lotin 2, ndërsa ne DT kriteret kanë qene te ndara për secilin lot veç e veç, qe do te thotë janë kërkuar dy menaxherë te projektit, andaj ju me ofertën e juaj e mbuloni vetëm njërin Lot, ne këtë rast për shkak te vlerës me te madhe u eshte përzgjedhur Lot 1 për kontrate.

Përgjigja e AK ne lidhje me pretendimet ankimore te oe Cactus Sh.a.

Konsiderojme se pretendimet e juaja ankimore jane te pa bazuara si te tilla Refuzohen dhe mbetet ne fuqi vendimi i AK.

Ne lidhje me pretendimet e juaj eshte mendimi unanım i pergjegjesve nga DSISH qe diploma e ofruar për analisten e projektit znj. Valentina Haziri - master ne menaxhimin e projekteve, nuk e plotëson kriterin e kërkuar ne DT.

Në dokumentin e tenderit, tek seksioni "KËRKESAT për kapacitetin teknik", është përcaktuar si kriter i domosdoshëm:

a. 1 (një) Analist i Projektit – Inxhinier i diplomuar në fushën e Kompjuterikës me Telekomunikacion ose me diplomë Master në Shkenca ose Inxhinieri Kompjuterike, me përvojë pune minimale 5-vjeçare pas diplomimit në rolin e analistit të sistemeve softuerike (të zhvilluara në platformën Microsoft .NET me SQL Server).

Dëshmitë e kërkuara:

Kopje e diplomës

CV e nënshkruar nga inxhinieri

Deklaratë për caktimin e Analistit të Projektit

Kontratë pune me punëdhënësin ose marrëveshje për angazhimin në këtë projekt

OE, në dokumentacionin e dorëzuar, ka ofruar si analist projektin një kandidat me diplomë "Bachelor of Information Technology and Systems" dhe "Master in Project Management", të cilat nuk përmbushin kriteret e kërkuara akademike të përcaktuara më sipër.

Gjithashtu, është kërkuar që kandidati të ketë të paktën 5 vite përvojë pune pas diplomimit në cilësinë e analistit të sistemeve softuerike të zhvilluara në platformën Microsoft .NET me SQL Server. Nga shqyrtimi i CV-së së paraqitur, rezulton se kandidati nuk zotëron përvojën e kërkuar në këtë fushë specifike. (faqe 31-34)

E rikonfirmojme konstatimin e komisionit vlerësues se oferta juaj është e papërgjegjshme për te dyja Lotet, pasi që Tek Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa Për Lot-in 1 (një) Analist i projektit Inxhinier i diplomuar i Kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike, me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit në cilësinë e analistit të sistemeve softuerike (të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server). Ju keni ofruar për Analiste te projektit znj. Valentina Haziri e cila ka ofruar një diplome bachelor te teknologjisë informative si dhe një diplome master ne menaxhimin e projekteve, diplome e cila nuk e plotëson kriterin e kërkuar ne DT.

Ju keni ofruar te njëjtin staf për te dy lotët edhe pse ne DT kane qene te ndara kriteret e kërkuar për stafin e angazhuar ne këtë projekt, dhe si e tillë nuk e plotëson kriterin e kërkuar ne DT.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

ZPP, Udhëheqës i Div. te Prokurimit